



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 10, datë 16.10.2017

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS SHKODËR-VELIPOJË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Rikonstrukcioni i Rrugës Shkodër-Velipojë”, me subjekt zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës do të lëshohet vetëm pas:
 - a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë e shpronësuara;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkive Shkodër dhe Vau i Dejës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

